

PROGRAMI I BASHKËPUNIMIT
NDËRMJET
AKADEMISË DIPLOMATIKE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
DHE
AKADEMISË DIPLOMATIKE TË MALIT TË ZI¹

Me dëshirën që të vendosin dhe zhvillojnë bashkëpunim në lidhje me hulumtimin e përbashkët dhe trajnimin e personelit diplomatik, Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës dhe Akademia Diplomatike e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Integritimit Evropian të Malit të Zi (këtu e tutje referuar si “Palët Nënshkruese”), kanë arritur mirëkuptimin e mëposhtëm:

Neni 1

Qëllimi i Programit të Bashkëpunimit (PB) është që të ndihmojë në krijimin e kushteve për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe promovimin e bashkëpunimit ndërmjet Palëve. Bashkëpunimi do të bazohet në reciprocitet dhe në përfitime të ndërsjella.

Neni 2

Palët i japin prioritet hulumtimeve të përbashkëta, prezantimin dhe elaborimin e metodave moderne për trajnimin e diplomateve dhe specialistëve në fushat e politikës së jashtme, marrëdhënieve ndërkombëtare dhe fushave tjera përkatëse. Palët planifikojnë të informojnë njëra-tjetrën për çështjet që kanë të bëjnë me hulumtime dhe teknika të mësimdhënies në fushat e lartpërmendura si dhe të shkëmbejnë literaturë dhe publikime përkatëse.

Neni 3

Bashkëpunimi sipas Programit të Bashkëpunimit (PB) mund të përfshij:

- (a) Operacione të përbashkëta dhe kurse të specializuara të trajnimeve;
- (b) Shkëmbim të materialeve mësimore;
- (c) Shkëmbim të studiuësve ose diplomatëve të rinj, me qëllim të përmirësimit të kualifikimeve të tyre;

¹ KY DOKUMENT NUK ËSHTË NË GJUHËN ORIGJINALE!

- (d) Shkëmbim të njohurive dhe përvojave lidhur me organizimin e mësimdhënies në institucionet akademike;
- (e) Konsultime të përbashkëta mbi kurset e gjuhëve të huaja;
- (f) Shkëmbim të eksperteve për pjesëmarrje në konferenca, simpoziume dhe panele të diskutimit në shtetet e tyre përkatëse;
- (g) Realizimi i projekteve të përbashkëta në fushat me interes të ndërsjellë;
- (h) Organizim i takimeve për çështje të interesit të ndërsjellë, ndërmjet përfaqësuesve të të dyja Palëve;
- (i) Çfarëdo forme tjetër e bashkëpunimit, e cila mund të vendoset bashkërisht nga Palët;

Neni 4

Secila Palë do të jetë përgjegjëse për bartjen e shpenzimeve të veta, të bëra me rastin e zbatimit të këtij Programi të Bashkëpunimit (PB), përveç nëse palët pajtohen ndryshe ndërmjet tyre.

Nenin 5

Ky Program i Bashkëpunimit (PB) është arritur për një afat kohor të pacaktuar, dhe do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit të tij.

PËRPILUAR në Prishtinë, me **15 prill 2014**, në dy kopje, në gjuhën Angleze.

**Për Akademinë Diplomatike të
Republikës së Kosovës**

Skënder Durmishi, Drejtor

**Për Akademinë Diplomatike të
Republikës së Malit të Zi**

...(e pa lexueshme)..., Drejtor